



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Edlira Hyseni, Arlind Çaçani, Ardiana Jaku, Artemis Dralo, Halit Valteri, Ervis Meço dhe Kostaq Papa.

Mungon:

Rudina Hajdari, Musa Ulqini, dhe Sadri Abazi.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale në Ministrinë për Ekonominë dhe Financat

Delina Ibrahimaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve

Ilda Koja – Drejtoreshë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Sot në Komisionin e Integritetit Europian do të shqyrtojmë projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i quajtur ndryshe fiskalizimi.

Për sa kohë që pjesa shoqëruese e këtij projektligji kishte një tabelë përputhshmërie me direktivat e BE-së, u mundësua që të kemi sot në mbledhje nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave: zotin Elton Haxhi, zëvendësministër, zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, zonjën Delina Ibrahimaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe zonjën Ilda Koja, drejtoreshë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Sigurisht, pa humbur kohë, unë do të doja t’ia jepja fjalën fillimisht zëvendësministrit dhe pastaj për pjesën e opinionit për sa i përket përafrimit me direktivat dhe legjislacionin e Bashkimit Europian, zotit Kasneci, lidhur me rekomandimet, për të vijuar me pyetje dhe diskutime nga anëtarët e komisionit.

Fjala është për ju, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Të nderuar deputetë,

Kemi sjellë për miratim projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i cili është punuar gjatë gjithë vitit 2019 edhe me asistencë të huaj, është konsultuar gjerësisht me aktorët e interesit, përfshirë kompanitë që do ta ofrojnë këtë shërbim, si dhe me të gjithë komunitetin e biznesit, dhe vjen për miratim i përmirësuar pas reflektimit të disa sugjerimeve apo komenteve të bëra nga aktorë të ndryshëm.

Do të doja të theksoja dy-tri risi që sjell ky projektligj, pasi ne aktualisht e kemi një sistem fiskalizimi, i cili përfshin vetëm transaksionet me para në dorë. Ky projektligj, përveçse përmirëson fiskalizimin e këtyre transaksioneve para në dorë, fut në fiskalizim edhe transaksionet pa para në dorë.

Risite

Projektligji sjell një rikonceptim të pajisjeve fiskale, duke përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me *software*-in, i cili do të përdoret për fiskalizimin e këtyre transaksioneve që unë përmenda. Në të njëjtën kohë, realizon transmetimin e çdo transaksioni në kohë reale, qoftë ato me para në dorë, qoftë ato pa para në dorë, si dhe transaksionet me qeverinë, pra marrëdhëniet biznes-qeveri; siguron për administratën tatimore një administrim

më të mirë dhe një efikasitet të shtuar në lidhje me informacionin e marrë dhe me përpunimin e tij, duke i siguruar administratës tatimore disa module ekstra, të cilat nuk i ka për momentin, që do të realizojnë edhe kontrollin tatimor në distancë dhe më efikasitet. Nga ana tjetër, siguron hapjen e tregut për kompanitë që e ofrojnë këtë shërbim fiskalizimi, duke mos u kufizuar në një numër të mbyllur të kompanive të licencuara, por duke e hapur tregun dhe duke përcaktuar disa specifikime teknike, të cilat, nëse e kalojnë testin, pra këto kompani mund të fillojnë ta ofrojnë këtë shërbim fiskalizimi, por njëkohësisht, përmbushin edhe disa kriteret minimale që do të përcaktohen me VKM (ne e kemi nxjerrë për konsultim publik edhe këtë VKM).

Përveçse sa më lart, janë edhe disa elemente të tjera, të cilat janë risi të këtij projektligji, siç është: inventarizimi i mallrave, i aseteve; kontrolli i gjendjes së parasë në arkë të çdo tatimpaguesi dhe një opsion, të cilin ne po e konsiderojmë ende, që është kodifikimi i produkteve, sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave apo një kodi tjetër që do ta gjejmë më të përshtatshëm. Por këto janë ndryshime, të cilat do të konsiderohen në vijim dhe do të përcaktohen nëpërmjet udhëzimeve të ministrit.

Pasi projektligji parashikon implementim me faza, pra jo të gjitha transaksionet do të fiskalizohen në të njëjtën kohë, fillimi do të jetë me miratimin e ligjit. Pra, sipas afateve të hyrjes në fuqi të ligjit, nga ai moment do të fillojë implementimi i fiskalizimit për transaksionet me para në dorë. Më 1 janar të vitit 2021 fillon fiskalizimi i transaksioneve biznes – qeveri, kurse më 1 korrik të vitit 2021 fillon fiskalizimi i detyrueshëm i transaksioneve pa para në dorë. Tek transaksionet me para në dorë janë përcaktuar disa dispozita transitorë, të cilat do të bëjnë të mundur edhe konvertimin e pajisjeve fiskale ekzistuese me *software* të rinj. Pra, nga diskutimet që ne kemi pasur me grupet e interesit është folur që shumica e pajisjeve fiskale ekzistuese do të konvertohet me sistemin e ri, me përmirësimet e nevojshme që duhen të modemi apo tek elemente të caktuara të tyre. Gjithashtu, edhe tatimpaguesve të rinj, të cilët do të regjistrohen gjatë kësaj periudhe, u është lënë një periudhë transitorë për t'u fiskalizuar me *software*-in e ri, e cila shtrihet nga hyrja në fuqi e ligjit deri në qershor të vitit 2020. Pra, kemi lënë një periudhë gjashtëmujore me afate të përshkallëzuara sipas kategorisë së tatimpaguesve. Domethënë, cilët janë tatimpagues ekzistues kanë një afat transitor, por edhe tatimpaguesit që regjistrohen të rinj gjatë kësaj periudhe kanë një afat për t'u pajisur me këto pajisje fiskale.

Projektligji, gjithashtu, parashikon faturën elektronike. Pra, më 1 korrik të vitit 2021 tek transaksionet pa para në dorë parashikohet edhe përafrimi i direktivës, pra hyrja në fuqi e

direktivës në lidhje me *e-invoice*, e cila do të bëjë të mundur edhe shkëmbimin e këtyre faturave elektronike nëpërmjet platformës së Bashkimit Europian, pra edhe me tatimpaguesit jorezidentë (qoftë eksporte, qoftë importe).

Nëse ka pyetje, jemi të hapur t'u përgjigjemi.

Faleminderit!

Senida Mesi – Nëse ju keni informacion apo ndonjë koment shtesë: me cilat direktiva të Bashkimit Europian ky projektligj parashikohet të implementohet? Përafrimi është i pjesshëm, apo i plotë? Fjalën mund ta marrë ose zoti Haxhi, ose zonja Brahimaj. Në të kundërt, do t'ia kaloj fjalën zotit Kasneci, drejtorit të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, për të na komentuar lidhjen me përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Europian, për sa kohë ky është fokusi i punës së këtij komisioni. Ndërkohë, në detaje ne e kemi trajtuar dhe po vijojmë. Sot e kaluam në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por do ta vazhdojmë diskutimin e tij nen për nen ditët në vijim, me ndryshimet ose sugjerimet e anëtarëve të komisionit. Sigurisht, ky ligj synon të rrisë formalizimin, implementimin e një teknologjie të re, ku informacioni përçohet në kohë reale. Raporti i xhirove, sidomos duke fillua nga marrëdhëniet biznes – qeveri, biznes – biznes, duke filluar me biznesin e madh dhe pastaj njëfarë kohe dhe gradualiteti për të kaluar në të gjitha subjektet; rrit eficiencën, gjë që është shumë e rëndësishme qoftë për transmetimin dhe përpunimin e databazave të informacionit nga bizneset, por shumë e rëndësishme edhe nga administrata tatimore.

Në lidhje me përafrimin e legjislacionit, që është edhe qëllimi i punës së këtij komisioni, nëse keni komente, fjala është për ju.

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Projektligji përafrohet në mënyrë të pjesshme me direktivën nr. 55 të vitit 2014 të Parlamentit Europian, edhe me direktivën e TVSH-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Fjalën e ka zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç u prezantua edhe nga përfaqësuesit e qeverisë, projektligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” përafrohet pjesërisht me dy aktet e legjislacionit europian, konkretisht me direktivën 2014/55 të Parlamentit Europian të datës 16.04.2014 “Për faturimin elektronik në prokurimin publik”, dhe me direktivën 2006/112 të Këshillit “Për sistemin e përbashkët të taksës mbi vlerën e shtuar”, e ndryshuar”.”.

Në opinionin ligjor që Shërbimi ynë ka përgatitur, kemi paraqitur katër vërejtje jothelbësore: vërejtja për CELEX-in dhe tri të tjera, të cilat për eficiencë të kohës suaj i kemi diskutuar dhe i kemi dakordësuar edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Kasneci!

Vijojmë me pyetje dhe diskutime nga kolegët lidhur me projektligjin në fjalë. Kush e do fjalën?

Edlira Hyseni – Meqenëse është një ligj tejet i diskutuar dhe i komentuar këto kohë, madje ka krijuar, le të themi, edhe mjaft paqartësi, pasiguri ose dilema te biznesi (në fakt, ky projektligj do të diskutohet edhe te Komisioni i Ekonomisë, ku, gjithashtu, jam anëtare), pyetjet e mia po i përfshij edhe në Komisionin e Integritetit.

Edhe në dëgjuesën që ne patëm pak më parë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat me operatorë të ndryshëm brenda vendit, u parashtruan disa çështje që mund të themi se janë ende të paqarta, sado ky projektligj u miratua në parim nga parlamenti seancën e kaluar.

Pyetja e parë që dua të bëj është edhe më e thjeshta. Një model të tillë e ka implementuar Italia fqinje dhe ka një ide se nuk ka qenë e thjeshtë, e suksesshme apo janë hasur goxha problematika në praktikë. Ju i referoheni Kroacisë, por më kanë thënë se edhe aty ka pasur probleme. A mendoni se Shqipëria dhe biznesi shqiptar janë gati? Po flasim që ky ligj do të prekë biznesin e vogël dhe atë të madh, se biznesi i madh ndoshta është pak më i organizuar, por e dimë se si funksionon biznesi i vogël, pra nuk flasim vetëm për biznesin në Tiranë apo në qendër të saj, por kudo në periferi dhe në vendet më të largëta. Ky ligj kërkon domosdoshmërisht internetin, pajisjet kompjuterike e të tjera risi që sjell. A mendoni që Shqipëria është sot gati? Edhe me situatën e krijuar së fundi, mund t'ju them se biznesi në Durrës ka goxha probleme që janë shkaktuar edhe nga situata më e fundit. Kështu që biznesi në Durrës ka nevojë më shumë për ndonjë rrethanë lehtësuese, që shpresoj, meqenëse kemi prezente edhe drejtoreshën e Përgjithshme të Tatimeve, të ketë ndonjë plan konkret se si mund ta ndihmojë biznesin në Durrës në situatën e krijuar. Por, gjithsesi, meqenëse ky ligj i ri parashikohet t'i ketë shpejt efektet, a është gati Shqipëria për ta bërë këtë?

Së dyti, duket e paqartë, por është krijuar ideja e thjeshtë që me ligjin e ri pajisjet fiskale (kasat fiskale aktuale) dalin tërësisht jashtë funksionit, jashtë përdorimit. Pra, biznesit të vogël dhe të madh i thuhet: ato kasat që keni mësuar t'i përdorni prej kaq vitesh (dhe nuk është e thjeshtë, pasi nuk dinë ende të nxjerrin një raport mujor) nuk do t'ju duhen më. Çfarë

kostosh keni bërë? Nuk do t'ju duhen më, sepse ky sistem është tërësisht i ri, i cili i nxjerr jashtë përdorimit kasat? Të paktën ky është perceptimi ose çfarë është kuptuar në publik.

Do të doja ta sqaronit qartë nëse sistemi i ri i përjashton absolutisht kasat fiskale, apo mund të ketë një ndërthurje ose një mënyrë se si të operojë edhe sistemi i ri fiskal së bashku me kasat që aktualisht përdoren nga bizneset.

Pyetja e tretë lidhet me kostot. Në dëgjesat e Komisionit të Ekonomisë u hap debati, por pastaj u la përgjysmë, pasi u duk disi preokupues, ndoshta informacionet nuk janë ende të qarta (ligji do të kalohet nen për nen dhe ndoshta informacionet do të detajohen edhe më shumë), por në dëgjesat e bëra u parashtruan kostot... Pra, ligji i ri do të ketë kosto për biznesin dhe, kur flasim për biznesin, e kemi fjalën për biznesin e vogël, të mesëm, të madh dhe kushdo është ai. T'i thuash sot biznesit shqiptar se do t'i rriten kostot, e frikëson që sa e dëgjon, jo më kur do të ndeshet me to. Na u tha se si kosto minimale, sikur të startojë sot një biznes i ri që ka nevojë për ta zbatuar këtë ligj i duhen minimalisht 1200 e ca euro, - diçka e tillë na u tha. Kostoja e mirëmbajtjes së sistemit, sipas ligjit, do të jetë minimalisht 5 mijë lekë të rinj në muaj. Pra, janë kosto të ndjeshme, të rëndësishme që i trembin të gjithë, jo vetëm biznesin e vogël. A keni ju një përlllogaritje tuajën, një preventivë, një ide tuajën afërsisht, pavarësisht se do të jetë e hapur pastaj gara, apo do të konkurrojnë shumë? A keni ju një ide se me sa do ta rëndojë biznesin (nga i vogli tek i madhi) ky ndryshim i madh?

E fundit, u propozua dhe unë mendoj se është e drejtë, por nuk e di nëse ju e keni në konsideratë, mundësia që t'u lihet një hark kohor i nevojshëm bizneseve sa të adaptohen me të rejat që vijnë dhe të mos të aplikohen gjobat që, në mos gabo, fillojnë nga 50 mijë lekë të rinj për biznesin e vogël, nga 100 mijë lekë të rinj për bizneset me TVSH dhe nga 150 për biznesin e madh, pak a shumë për shkelje të ndryshme. A mund të bëhet që të paktën për një vit ose për 18 muaj të përjashtohet mundësia e penaliteteve dhe e gjobave për bizneset, qoftë edhe për gabimet që ato mund të bëjnë gjatë implementimit të ligjit të ri? A nuk është e domosdoshme që të mos trembet biznesi, përveç kostove dhe ndryshimeve të tjera, por të paktën t'u jepet kohë bizneseve që të adaptohen dhe të mos penalizohen nga gjobat që parashikon ligji?

Faleminderit!

Senida Mesi – Zonja Hyseni, ju falënderoj, pavarësisht se pyetjet ishin shumë teknike dhe jo për Komisionin e Integritetit Europian dhe për Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, por janë çështje që qëndrojnë për Komisionin për Ekonominë dhe Financat, të cilat i kemi diskutuar dhe do të vazhdojmë t'i diskutojmë, do t'i keni edhe me shkrim këto

pyetje, sidomos për pjesën e kostove, të cilat prekin në mënyrë direkte qoftë bizneset ekzistuese, qoftë bizneset e reja. Megjithatë, në respekt edhe të koleges, le të marrim një sqarim shkurtimisht për këto katër pika. Më në detaje do të kemi mundësi t'i trajtojmë këto në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Fjala është për ju, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Shkurtimisht, në lidhje me problematikën e implementimit të këtij projektligji, ne kemi pasur një proces shumë të gjatë konsultimi me të gjithë aktorët e biznesit dhe kemi diskutuar qoftë në lidhje me radhën e aplikimit, qoftë me periudhën e nevojshme, e cila duhet për të qenë gati.

Nga konsultimet e kryera, debati kryesor ka qenë që të fillojmë me biznesin e madh apo me biznesin e vogël. Tani, i referohemi kështu, por në të vërtetë nuk është tamam kështu. Ne po e fillojmë me biznesin që kryen transaksione me para në dorë dhe këto të fundit i kryen edhe biznesi i vogël, edhe biznesi i madh. Pra, të mos bëjmë një ndarje: biznes i madh, biznes i vogël, sepse ka shumë biznese të mëdha që kryejnë transaksione me para në dorë dhe që duhet të fiskalizohen të parët.

Pse e filluam me transaksionet me para në dorë? Për arsye të riskut, në radhë të parë, sepse është sektori që ka më shumë risk. Pra, paraja kesh është më e prirur të jetë e përfshirë, pra një nga faktorët e informalitetit.

Së dyti, përfshin një masë shumë të madhe të gjenerimit të të ardhurave, pra ka një impakt të madh në të ardhurat tatimore.

Së treti, ne kemi një sistem ekzistues me kasa fiskale, që mund ta quajmë fiskalizim, që transmeton një herë në ditë. Veprimet që kryen secili shitës janë të njëjta. Pra, veprimet që do të duhet të kryejë shitësi në lidhje me përgatitjen e faturës, me lëshimin e faturës, nuk ndryshon në thelb. Quhej kupon, ndërsa tani quhet faturë; pak rëndësi ka, sepse veprimet janë njëjloj. Instalimi dhe protokoli i komunikimit ndryshon, por kjo nuk ka të bëjë direkt me tatimpaguesin. Pra, nuk kërkohet ndonjë angazhim shumë i madh i tatimpaguesit në të gjithë këtë proces. Është më tepër punë e kompanive, të cilat do të ofrojnë shërbimin e fiskalizimit.

Nga diskutimet që kemi bërë me kompanitë, na është thënë se u nevojiten dy muaj që të përgatisin *software*-in. Pastaj, në varësi të tatimpaguesve që do t'u shërbejnë, mund t'u nevojitet një periudhë kohore deri gjashtë muaj për ta implementuar këtë sistem tek të gjithë tatimpaguesit. Por kjo varet edhe nga numri të cilit ato do t'i shërbejnë. Ne kemi lënë një periudhë gjashtëmujore për këtë qëllim. Pra, e gjithë periudha e tranzicionit është gjashtë muaj.

Për sa u përket kasave, nuk përjashtohen. Ne nuk kemi vënë asnjë specifikim teknik në lidhje me *hardware*-in, sepse kontrollojmë *software*-in. Tani *software*-in mund ta instalosh te kasat ekzistuese ose në një *hardware* tjetër, në një pajisje tjetër. Pra, nuk përjashtohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, thjesht e kemi hapur mundësinë që mund të përdoren kasat ekzistuese ose një *hardware* (pajisje) tjetër.

Për sa u përket kostove, ne nuk kemi asnjë nga operatorët të cilët po testojnë produktet. Nuk janë të gatshëm të japin një kosto. Kjo është e arsyeshme për çështje konkurrence, për çështje të tjera tregu.

Nga informacioni që ne kemi nga vendet që e kanë përdorur këtë sistem, po t'i konvertojmë në çmimet e vendit tonë, kostot shkojnë nga 7 deri në 10 euro në muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse ne dhe operatorët me të cilët kemi diskutuar mendojmë se ky do të jetë një shërbim, nuk është një... Pra, ti do të blesh një shërbim fiskalizimi. Ata mendojnë se do ta ofrojnë si *software as a service*, jo si produkt që ti ta blesh si *software*. Këtë të fundit ti mund ta përdorësh qoftë në një laptop, qoftë në një *iPhone*, në një *tablet* tjetër ose nëse do ta ofrojnë kompanitë e kasave fiskale për kasat e tyre fiskale.

Për sa i përket lehtësimit për gjobat, periudha gjashtëmujore, që e kemi lënë si periudhë tranzicioni, do të shërbejë për një tranzicion sa më të lehtë dhe për të mos pasur probleme me penalitetet. Por në momentin që ti transmeton për një herë të parë dhe regjistrohesh si i tillë, i ke të gjitha mundësitë që të mos bësh gabime. Për më tepër, në rastet kur kemi probleme me internetin, probleme me energjinë dhe mënyrat se si veprohet dhe që të mos ketë nevojë për aplikim gjobash janë të gjitha të parashikuara në projektligj. Pra, mund të mos transmetosh brenda një afati 72-orësh, në mos gabo, dhe pas 72 orësh, me vendosjen e lidhjes së internetit, ti i transmeton në bllok të gjitha transaksionet që ke regjistruar gjatë asaj periudhe. Pra, i kemi lënë të gjitha mundësitë e parashikimeve të problemeve me infrastrukturën apo për transmetimin me internet.

Senida Mesi – Zoti Haxhi, ju falënderoj!

Është e rëndësishme të kemi informacion për kostot, por që edhe këto kosto të jenë oportune. Pra, një kosto që subjektet e paguajnë sot për mirëmbajtjen e kasave apo të pajisjeve ekzistuese, të zëvendësohet me një kosto mundësisht më të ulët me *software*-in e ri të implementuar. Pra, është në interesin e qeverisjes së kësaj maxhorance që ne të mos

shtojmë asnjë kosto shtesë, qoftë për bizneset e vogla, sidomos në veçanti, por edhe për bizneset e mëdha.

Nëse nuk ka pyetje ose diskutime të tjera nga kolegët, do të doja ta kaloja në votim.

Hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”?

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Në lidhje me sugjerimet, duke filluar që nga shpjegimi në lidhje me çfarë direktive përafrohet.

Për nenet 25, 28 dhe 46 jeni dakordësuar me ministrinë?

Po, zoti Haxhi.

(Zëvendësministri flet pa mikrofon.)

Jeni dakordësuar me propozimin e amendimit të Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit?

Atëherë, kalojmë në votimin nen për nen, me sugjerimet dhe rekomandimet e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju faleminderit për kohën!

MBYLLET MBLEDHJA